

Fillimi > -Kronikë

Të shtëna me armë zjarri pas mesnatës në Tiranë, plagoset 34-vjeçari, arrestohet një nga autorët

13 Qershor, 2021 07:50



Madhësia e tekstit: - +

Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur rreth mesnatës së kaluar në Tiranë. Policia njofton se ka mbetur i plagosur në këmbë 34-vjeçari E. Gj., ndërsa është arrestuar autori i dyshuar i plagosjes, 33-vjeçari K. Sh.

Gjithashtu, është shpallur në kërkim vëllai i autorit, 25-vjeçari R. Sh., pasi dyshohet si bashkëautor i ngjarjes, si dhe një shtetas tjetër për veprën penale “Moskallzim Krimi”.

Gazetarja Dorjana Bezat zbardh për “**BalkanWeb**” emrat e autorëve dhe të plagosurit. Kështu, i plagosur ka mbetur shtetasi Ergin Gjoni, ndërsa autorë janë vëllezërit Klajdi dhe Ramadan Shanaj. Gjithashtu, në kërkim për moskallëzim krimi është shpallur edhe Valter Pershpalaj.

Njoftimi i policisë:

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr.4, falë reagimit në kohë dhe veprimeve hetimore dhe profesionale bënë të mundur arrestimin e njërit prej autorëve të dyshuar, konkretisht shtetasin K. Sh., 33 vjeç, për veprat penale “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” e kryer në bashkëpunim” “Armëmbajtja pa leje” dhe “Prishja e qetesisë publike”

Dhe po për të njëjtat vepra penale shpallën në kërkim vëllain e tij shtetasin R. Sh., 25 vjeç.

Gjithashtu u shpall në kërkim për veprat penale “Moskallzim krimi” dhe “Plagosje e lehtë me dashje” dhe shtetasi V.P.

Shtetasit K. Sh dhe R. Sh (vëllezër)në bashkëpunim me njëri-tjetrin, mbremjen e djeshme, rreth orës 23:45, pas një konflikti të çastit për motive të dobëta, në rrugën “Karaman Ylli” kanë plagosur me armë zjarri në këmbë, shtetasin E. Gj., 34 vjeç, i cili ndodhet nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Nën drejtimin e Prokuorisë vijon puna për dokumentimin e plotë të kësaj ngjarje.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arrestim plagosje me arme Tirane

TË NGJASHME

Arrestohet në Morinë 41-vjeçari kosovar, i gjenden në valixhe dokumente të falsifikuara17 Qershor, 2021

Po transportonin 22 emigrantë të paligjshëm, arrestohet në Korçë 41-vjeçari, në kërkim bashkëpunëtori i tij17 Qershor, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Aksident në hyrje të spitalit “Nënë Tereza”, një makinë përplaslet me një motomjet17 Qershor, 2021

E para grua ushtarake gradohet Gjeneral Majore, dekretohet nga presidenti MetaAurora Golemi | 17 Qershor, 2021

Pamjet nga vendngjarja/ Humbi jetën në aksidentin në Fier, identifikohet viktima (EMRI)17 Qershor, 2021

Aksidenti i rëndë në Fier, makina del nga rruga, ndërron jetë një person17 Qershor, 2021

Vrasja e Nezir dhe Gentjan Beqirit, SPAK njoftim zyrtar për dërgimin në gjyq të dosjes së Ardian Çapjas17 Qershor, 2021

GJKKO dënon për shpërdorim detyre ish-kryebashkiaken e Gjirokastrës: Të kryejë punë në interes publik17 Qershor, 2021

KATEGORIA VIDEO

Zgjedhjet për kreun e PD/ “Jemi në një moçal demokracie”, Vasjari: Dështoi Basha dhe kundërshtarët e tij, betejë brenda një partie mes dy grupeve17 Qershor, 2021

Gara për drejtuesin e PD/ Nazarko: Po kthehemi në shoqëri gjysmë-feudale, duhet të ndryshojë statuti, nëse nuk fiton zgjedhjet ‘ikën në shtëpi’17 Qershor, 2021

Zgjedhjet për kreun e PD, Malko: Dy shkeljet në garë, Basha do të ishte kandidati më i pafavorizuar nëse...17 Qershor, 2021

Krimi që tronditi Greqinë, mediat greke të bindura: 20-vjeçarja u vra nga bashkëshorti!17 Qershor, 2021

Pamjet nga vendngjarja/ Humbi jetën në aksidentin në Fier, identifikohet viktima (EMRI)17 Qershor, 2021

Emërimi i kreut të IKMT-së në Shkodër, denoncimi i PD: Kandidati për deputet i PSD-së së Doshit17 Qershor, 2021

BalkanWeb	EMISIONE NEWS24	KATEGORI	MEDIAT E HUAJA
FAQET ZYRTARE	Alert	Fillimi	New York Times
	Emisioni Diplomaticus	Shqipëria	Guardian
	Emisioni Vila 24	Kosova	WEB BBC
	Kjo Javë	Rajoni	WEB CNN
News24	Klinika 24	Sport	REUTERS
Gazeta Shqiptare	Koha për t'u zgjuar	Bota	Washington Post
Radio RASH	Me zemër të hapur	Kulturë	Times Online
PRIVATËSIA	Monitor Ekonomi	Metropol	Financial Times
	Real Story	Analiza	WEB Yahoo
POLITIKA E PRIVATËSISË	Shqiptarët për shqiptarët	Teknologji	WEB MSN
	Sport News		USA Today
	Sport News Plus		

redaksia@balkanweb.com